



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Procesverbal i mbajtur më 15 qershor 2021, në mbledhjen e L-të (pesëdhjetë) – e jashtëzakonshme, të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VI.

E thirrur në kërkesë të Kryetarit të Komunës, nr.prot.01-060/01-0046624/21 të datës 10 qershor 2021,

Mbledhja filloi në orën 10;20 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve në objekt të Komunës.

Mbledhjen e kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës.

Në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë këshilltarët/et e Kuvendit të Komunës, përveç znj.Mrika Thaqi e cila mungoi, (Lista e nënshkrimeve).

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Gjithashtu në mbledhje të pranishëm ishin edhe z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, znj.Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, Drejtorët e Drejtorive (DPZHE, DKRS, DA, DSHPMSh, DPKGJ, DKA, DBPZHR) të Komunës së Podujevës, si dhe një numër i zyrtarëve komunal.

Me këtë;

Rend dite

- 1. Kërkesë për nismën e procedurës për bashkëpunim komunal ndërkombëtar në formën e binjakëzimit me Qytetin / Komunën Kestel të Regjionit të Bursa në Republikën e Turqisë**
 - ***Propozim Vendimi për miratimin e Kërkesës-Nismës së Bashkëpunimit Komunal Ndërkombëtar-Binjakëzimit me Qytetin / Komunën Kestel të Regjionit të Bursa në Republikën e Turqisë.***
 - ***Propozim Vendimi për Autorizimin e Kryetarit të Komunës për fillimin e konsultimeve për Bashkëpunim Komunal Ndërkombëtar-Binjakëzim me Qytetin/Komunën Kestel të Regjionit të Bursa në Republikën e Turqisë.***
- 2. Kërkesë për nismën e procedurës për bashkëpunim komunal ndërkombëtar në formën e binjakëzimit me Qytetin / Komunën Linz të Republikës së Austrisë**
 - ***Propozim Vendimi për miratimin e Kërkesës-Nismës së Bashkëpunimit Komunal Ndërkombëtar-Binjakëzimit me Qytetin / Komunën Linz të Republikës së Austrisë.***
 - ***Propozim Vendimi për Autorizimin e Kryetarit të Komunës për fillimin e konsultimeve për Bashkëpunim Komunal Ndërkombëtar-Binjakëzim me Qytetin/Komunën Linz të Republikës së Austrisë.***

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen duke i'u dëshiruar mirëseardhje dhe punë të mbarë të pranishmëve, konstatoi pjesëmarrjen gjegjësisht kuorumin, në vazhdim shtoi, kjo mbledhje është thirr në kërkesë të Kryetarit të Komunës siç edhe keni mund ta vëreni në thirrjen dhe materialin e dërguar duke përfshirë edhe temat përkatëse që kanë të bëjnë me nisma të bashkëpunimit me qytete / komuna të shteteve mike të Kosovës që janë Kestel të Regjionit të Bursa në Republikën e Turqisë si dhe Linz të Republikës së Austrisë, me qëllim të fillimit të proceduarve për binjakëzim. Lidhur me këtë dhe çështje tjera që kanë të bëjnë me temat e cekura, ftoj Kryetarin e Komunës për një fjalë hyrëse.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, paraqiti kërkesat në fjalë, ndër të tjera theksoi, siç e potencoj paraprakisht edhe Kryesuesi i Kuvendit, arsyeja e thirrjes së kësaj mbledhje të jashtëzakonshme të Kuvendit janë dy kërkesa - nisma për bashkëpunim komunal, njëri ndërmjet Qytetit / Komunën Kestel të Regjionit të Bursa në Republikën e Turqisë dhe tjetri me Komunën Linz të Republikës së Austrisë.

Dëshiroj t'ju informoj se javën e kaluar, së bashku me një delegacion nga Ekzekutivi i Komunës, përmes një ndërmjetësimi nga Qendra Kulturore e Bursa në Republikën e Turqisë dhe Republikës së Kosovës kemi vënë një kontakt të mëparshëm me Komunën Kestel të Regjionit të Bursa, dhe në vazhden e këtyre kontakteve që kemi pasë me komunën e cekur e në veçanti me Kryetarin e kësaj komune, ne kemi realizuar një vizitë zyrtare në atë vend ku kemi pasë rastin të pritemi nga një numër i delegacioneve të ndryshme në shumë komuna të Regjionit të Bursa dhe ajo që ishte më e rëndësishmja ishte kontakti me Kryetarin e Komunës Kestel, Komunë kjo e cila përafërsisht me numër të banorëve është sa Komuna jonë, dhe gjatë vizitës erdhëm në përfundim se Komuna e Podujevës dhe Komuna Kestel kanë një sër elementesh të përbashkëta ku njëri prej atyre elementeve ishte bujqësi si një veprimtari e rëndësishme në atë Komunë përkundër faktit që përshkruhej edhe si Komunë industriale relativisht e zhvilluar në regjionin e Bursa. Në kuptimin e bujqësisë, një informacion që na u dha gjatë vizitës është që Komuna në fjalë ishte prodhuesja e 70% mjedres në gjithë Turqinë, element ky i cila na përafron shumë me Komunën tonë në kuptim të kësaj kulture.

Çështja tjetër që vlen të potencohet është se ishte një Komunë me një numër jashtëzakonisht të qytetarëve tanë të cilët dikur në periudhat e mëparshme kanë ikur nga Kosova, në këtë kontekst po e marrë një shembull, gjatë një vizite që kishim në njërën prej bizneseve private ishte një person me emrin Fahrudin i cili ishte nga Gjilani dhe i cili po udhëheqte një biznes me rreth 1300 të punësuar dhe për çudi ishte një prej kompanive më të forta dhe më të suksesshme në atë Komunë e cila po prodhonte me standarde ndërkombëtare pjesë për makina për markat Toyota, Fiat, Ford, WV dhe shumë e shumë punë tjera. Përveç kësaj ishte një Kompani e cila kishte filluar punën nga zeroja me disa punë shumë të thjeshta por që kishte avancuar shpejt dhe tani ishte kompania numër 1 në Turqi e cila prodhon teknologji të avancuara sa që ishte kompania më e besueshme edhe për aviacionin e republikës së Turqisë për prodhimin e pjesëve të caktuara të elektronikës.

Në vazhden e këtij takimi, nga ky bashkëvendës i joni na është premtuar se së shpejti do ta hapin një klasë me të gjitha aparataturat e nevojshme me qëllim të përgatitjes së nxënësve dhe mësimdhënësve tanë në funksion të avancimit të asaj teknologjie dhe po ashtu na është premtuar se ka mundësi që mësimdhënësit tanë t'i ftojnë dhe t'iu mbajnë trajnim për një periudhë të caktuar kohore në atë kompani, në shpenzime të tyre si dhe njëkohësisht edhe një numër të caktuar të nxënësve t'i ftojnë për aftësim në kompaninë e Tij me qëllim të aftësimit të tyre për t'i futur në funksion teknologjitë përkatëse.

Përveç kësaj na është ofruar mundësia që t'i vizitojmë edhe bizneset tjera të ndryshme bujqësore për arsye se edhe kushtet klimatike të cilat mbretëronin në atë Komunë pothuajse janë identike me kushtet klimatike që ka Komuna e Podujevës, prandaj edhe patëm rastin t'i vizitojmë edhe shumë

plantacione bujqësore, sidomos të pemëve të ndryshme, pastaj perim-kulturave të ndryshme, formën e organizimit që ishin përmes kooperativave bujqësore (jo në formën siç kanë qenë në periudhën e komunizmit), por kooperativa bujqësore të cilat po punonin drejtpërsëdrejti për mbrojtjen e interesit të bizneseve prodhuese në bujqësi dhe shumë fushave tjera, ku patëm një mikpritje shumë miqësore dhe në një formë nga krejt ato që vizituam dhe vërejtëm, unë mendoj që ne Komuna e Podujevës kemi dobi nga lidhja e një marrëdhënie bashkëpunimi dhe binjakëzimi me komunën e Kestel, sepse përveç fushave që i ceka për bujqësi dhe arsim, kemi mundësi të shikojmë edhe bashkëpunim edhe në segmentin e turizmit për të cilin mund të ndihmohemi shumë nga Kestel ngase qoftë nga Kryetari i Komunës së Kestel por edhe nga pothuajse të gjitha bizneset që kemi vizituar atje, kanë shpreh një gatishmëri për bashkëpunim.

Ajo që është më esencialja, një pjesë e madhe e popullatës së Kestel ishin me prejardhje Shqiptare dhe të cilët vazhdimisht shprehnin interesim për bashkëpunim me Komunën e Podujevës. T'ju them të drejtën, pronari i kompanisë për të cilën fola pak më parë zotëri Fahrudin mund të them se ishte një lloj Ambasador nderi i joni në Shtetin e Turqisë, dhe kishte një autoritet të jashtëzakonshëm ku pothuajse dyert për të ishin të hapura në gjithë Turqinë. Prandaj edhe përkundër informacionit të dhënë në dokumentacionin e dërguar me kërkesën për këtë mbledhje të cilën sigurisht e keni lexuar, unë sërish ju informoj dhe besoj shumë se një nismë e tillë dhe një përkrahje e tillë e këtij Kuvendi do të na bën nderë si komunë dhe do të na hap rrugë që në afatin sa më të shkurtër t'i ftojmë në një vizitë zyrtare një delegacion të komunës Kestel, të ulemi edhe njëherë bashkërisht dhe të analizojmë të gjitha fushat e bashkëpunimit që mund t'i bëjmë bashkërisht e që mendoj se është interes i Komunës së Podujevës.

Çështje tjetër është iniciativa apo nisma për binjakëzimin e Komunës së Podujevës me Komunën Linz të Republikës së Austrisë, qytet për të cilin besoj se shumica prej juve jeni në dijeni se ku gjendet dhe besoj se keni pasë rast të lexoni edhe për karakteristikat e kësaj komune, qytet i cili ekskluzivisht është industrial dhe me një industri relativisht të zhvilluar. Unë përmes një miku me emrin Shkelzen i cili punon në atë qytet dhe është doktor i shkencave në Republikën e Austrisë dhe një person shumë i afërt i kësaj Komune, kemi pasë një mirëkuptim dhe jemi vënë në kontakte ku përmes platformave virtuale online kemi pasë disa kontakte dhe kemi ardh në një kompromis dhe një gatishmëri të Kryetarit të komunës së Linz që ta avancojmë bashkëpunimin tonë dhe në vazhden e bashkëpunimit, ashtu siç keni mund ta shihni të bashkëngjitur me dokumentacionin e kësaj thirrje, para disa ditëve, përkatësisht më datën 02.06.2021 kemi pranuar edhe një ftesë zyrtare nga Kryetari i komunës së Linz me të cilën është kërkuar që një delegacion i komunës së Podujevës ta vizitoj Komunën e Linz dhe të ketë takime zyrtare me përfaqësuesit e kësaj komune në mënyrë që t'i fillojmë urat e bashkëpunimit në mes dy komunave Podujevë - Linz, bashkëpunim i cili, ndër të tjera mund të bëhet në fushat e zhvillimit ekonomik për arsye se kryesisht është komunë e cila ka industrinë e zhvilluar, madje në bazë të informacioneve të marra nga Kryetari i komunës së Linz janë rreth 100 mijë të punësuar të cilët brenda ditës hyjnë dhe dalin nga qyteti i Linzit. Si komunë është shumë më e madhe se sa Komuna e Podujevës përkundër faktit që sipërfaqja e territorit është më e vogël se sa e Komunës së Podujevës por që e përsërisë sërish kemi të bëjmë me një komunë e cila në aspektin industrial është shumë e zhvilluar.

Po ashtu besoj shumë që fusha e bashkëpunimit do të mund të jetë edhe arsimi dhe krijimit të mundësive që nxënësve dhe studentëve tanë t'iu krijohen kushte dhe mundësi për vizita në Linz dhe bashkëpunimit të ndërsjellë, mirëpo me shpresën që edhe shumë gjëra tjera të cilat do t'i shtellojmë dhe analizojmë pasa takimit që do ta bëjmë më datë 01.07.2021 që është paraparë n'kuadër të vizitës zyrtare që do ta realizojmë.

Po ashtu ju informoj se vizita zyrtare do të mundësohet nga Ministria e Punëve të Jashtme e Austrisë në bashkëpunim me Ambasadën dhe konsullatën e Kosovës që ndodhet në atë pjesë, andaj besoj që me një delegacion do të kemi mundësi të realizojmë vizitën e paraparë në ftesë të Kryetarit të Komunës së Linz dhe sigurisht që pasi të kthehemi do të kemi mundësi dhe gatishmëri që t'ju ofrojmë informacione shtesë këtij Kuvendi dhe njëkohësisht t'i ofrojmë qëndrimet në funksion të procesit të binjakëzimit.

Pra këto ishin disa prej informacioneve në pika të shkurtra sa i përket çështjeve të propozuara për këtë mbledhje, në qoftë se ka ndonjë interesim për ndonjë sqarim shtesë, unë jam i gatshëm t'ju jap.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, të nderuar këshilltarë të Kuvendit patët mundësi ta dëgjoni prezantimin dhe arsyetimin e Kryetarit të Komunës rreth pikave dhe çështjeve të proceduara për këtë mbledhje të Kuvendit të Komunës, përkatësisht rreth aktiviteteve të zhvilluara për nismën e procedurave për binjakëzim me dy komunat në fjalë, çështje për të cilat sigurisht që keni mund t'i shikoni edhe në materialet e dërguara me thirrjen e kësaj mbledhje.

Paraprakisht ju them se aktualisht në sallë jemi 33 këshilltarë të Kuvendit, nëse jeni të pajtimit ne mund t'i shqyrtojmë të dyja pikat në një pikë të vetme në mënyrë që proceduralisht të shpejtohet dhe konkretizohet kjo çështje, për çka edhe Kryetari i Komunës paraprakisht e paraqiti fjalën hyrëse për të dy kërkesat respektivisht 4 propozim vendimet përkatëse.

Njëzëri përkrahet propozimi që dy pikat e propozuara sipas thirrjes dhe materialit përkatës të shqyrtohen njëkohësisht si një pikë e rendit të ditës dhe për të njëjtat të votohet përnjëherë.

z.Adnan Zymeri, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve të LDK-së i mbështesim kërkesat e Kryetarit të Komunës për nismat e Bashkëpunimit Komunal Ndërkombëtar-Binjakëzimit me Qytetin / Komunën Kestel të Regjionit të Bursa në Republikën e Turqisë, dhe Qytetin / Komunën Linz të Republikës së Austrisë.

Po ashtu do të mbështesim secilën nismë dhe iniciativë tjetër e cila mundëson zhvillimin e Komunës së Podujevës në mënyrë direkte apo indirekte.

z.Florent Hasani, theksoi, edhe ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së duke ditë rëndësinë e përfitimeve të Komunës së Podujevës nga bashkëpunimi komunal ndërkombëtar në formën e binjakëzimit, në këtë rast me komunën Kestel të Regjionit të Bursa në Republikën e Turqisë, e mbështesim nismën e Kryetarit të Komunës për ecjen tutje në realizimin e këtij bashkëpunimi.

Po ashtu mbështesim që ta autorizojmë Kryetarin e Komunës si konsultues me palën e Turqisë për përgatitjen e draft Marrëveshjes me qëllim të bashkëpunimit të ndërsjellë.

z.Fatmir Rudari, theksoi, po ashtu edhe ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së mbështesim nismat e propozuara. Nisma të tilla kemi mbështetur edhe në të kaluarën edhe pse në të kaluarën përveç disa vizitave në ato qytetet dhe komuna asnjëherë nuk kemi parë ndonjë rezultat, mirëpo pas sqarimeve që i bëri Kryetari i Komunës besojmë se do të kemi edhe rezultate në fushën ekonomike.

z.Avni Islami, theksoi, iniciativa të tilla kemi pasur edhe në të kaluarën siç ishte ajo e fundit me Komunën e Velbertit të Gjermanisë. Iniciativa të tilla besoj se janë të mirëseardhura për Komunën e Podujevës dhe për qytetarët tanë, prandaj bashkëpunimi mes komunave është i rëndësishëm sidomos për ne si Komunë e Podujevës, andaj edhe unë i mbështesë dhe presë që të ndërmerren edhe nisma tjera të tilla nga Kryetari i komunës dhe nga Kuvendi i Komunës.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, unë i hedh në votim dy kërkesat – nismat e propozuara nga Kryetari i Komunës, përkatësisht 4 propozim vendimet sipas thirrjen dhe materialit përkatës për këtë mbledhje.

Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri, me 34 vota PËR, miratohen Kërkesat – Nismat e paraqitura nga Kryetari i Komunës, përkatësisht propozim vendimet, si në vijim:

- Propozim Vendimi për miratimin e Kërkesës-Nismës së Bashkëpunimit Komunal Ndërkombëtar-Binjakëzimit me Qytetin / Komunën Kestel të Regjionit të Bursa në Republikën e Turqisë.

- Propozim Vendimi për Autorizimin e Kryetarit të Komunës për fillimin e konsultimeve për Bashkëpunim Komunal Ndërkombëtar-Binjakëzim me Qytetin/Komunën Kestel të Regjionit të Bursa në Republikën e Turqisë.

- Propozim Vendimi për miratimin e Kërkesës-Nismës së Bashkëpunimit Komunal Ndërkombëtar-Binjakëzimit me Qytetin / Komunën Linz të Republikës së Austrisë.

- Propozim Vendimi për Autorizimin e Kryetarit të Komunës për fillimin e konsultimeve për Bashkëpunim Komunal Ndërkombëtar-Binjakëzim me Qytetin/Komunën Linz të Republikës së Austrisë.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, falënderoj këshilltarët e Kuvendit për përkrahjen unanime të këtyre dy nismave, ndër të tjera theksoi, meqë kjo çështje shkoi siç duhet dhe që besoj se do të jetë në dobi të Komunës, po planifikoj që përfaqësuesit e Komunës Kestel të Republikës së Turqisë t'i ftoj menjëherë për një vizitë zyrtare në Komunën e Podujevës në fillim të muajit korrik në mënyrë që t'i konkretizojmë disa gjëra praktikisht këtu në Komunën e Podujevës.

Unë nga kjo foltore ju bëjë ftesë shëfave të Grupeve të këshilltarëve të kuvendit ose përfaqësuesve që mund të caktoni, që gjatë asaj vizite të jenë prezent së bashku me neve si Ekzekutiv i Komunës dhe ta shoqërojmë në çdo vizitë sipas agjendës të cilën do ta ketë për obligim ta përgatit Ekzekutivi i Komunës, në mënyrë që t'i presim sa më mirë përfaqësuesit e komunës në fjalë.

Po ashtu, nëse ky Kuvend e vlerëson që delegacionit të Komunës së Podujevës që do të udhëtoj për në Linz të Austrisë duhet t'i bashkëngjitet ndokush edhe nga Kuvendi i Komunës, për mua nuk paraqet kurrfarë pengese që të jetë pjesë e delegacionit kushdo që ju e vlerësoni që duhet të jetë nga Kuvendi i Komunës. Sigurisht që shpenzimet rriten, mirëpo sërish po e them që nëse ju e vlerësoni si të nevojshme që ndokush nga Kuvendi t'i bashkëngjitet delegacionit tonë për vizitë në Linz, mua si Kryetar i Komunës aspak nuk më pengon ajo çështje.

Gjithashtu në vizitën e radhës që do ta kemi në Komunën Kestel të Republikës së Turqisë do t'ju bëjë ftesë që të më bashkëngjiteni nga një këshilltar prej secilit subjekt që është i përfaqësuar në këtë Kuvend.

Meqë nuk pati të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 10:40

Procesverbalin e mbajti

Enis Sheholli

Nr.01-060/04-0047904/21

Podujevë,

15 qershor 2021

Kryesuesi i Kuvendit

Fatmir Gashi